

THAÇI: PRES LIRIMIN NGA ÇDO AKUZË I FAQE 4-5

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pret të shpallet i pafajshëm nga të gjitha akuzat në procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. I pyetur se cilat janë pritjet e tij nga procesi gjyqësor, Thaçi ka qenë i prerë. "Pres lirimin nga çdo akuzë. Nuk kam çka t'u shtojë argumenteve të ekipeve mbrojtëse, si dhe fjalës sime përfundimtare në sallën e gjyqit", ka thënë Thaçi në intervistën me shkrim për Debat Plus në RTV Dukagjini. Thaçi në këtë intervistë ka deklaruar se Serbia dhe Rusia synojnë ta delegjitimojnë dhe diskreditojnë shtetësinë e Kosovës, duke e lidhur këtë përpjekje edhe me procesin gjyqësor që po zhvillohet në Hagë



**NATO: ÇDO VENDIM
PËR RIHAPJEN
E URËS MBI IBËR
PËR VETURAT, T'I
ADRESOJË NEVOJAT
E TË GJITHA
KOMUNITETEVE F. 5**



**NATO: ÇDO VENDIM
PËR RIHAPJEN
E URËS MBI IBËR
PËR VETURAT, T'I
ADRESOJË NEVOJAT
E TË GJITHA
KOMUNITETEVE F. 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

**PSE DUHET TË BËJMË
NJË FILM NDËRKOMBËTAR
PËR SKËNDERBEUN F. 5**

Ben BLUSHI



AKTUALE



**SHBA-ja ZOTOHET SE DO
TË VENDOSË "SANKSIONET MË TË
ASHPRA" NË HISTORI NDAJ IRANIT F. 2**

**AKB-ja: PRODHUESIT NUK JANË
'PRODHUES TË SË KEQES',
ATA E MBAJNË GJALLË
EKONOMINË E KOSOVËS F. 7**

EKONOMI



**QARKULLIMI NË SEKTORIN
E SHËRBIMEVE BIE 0,37 %
NË QERSHOR, RITEN PUNËSIMI
DHE FONDI I PAGAVE F. 8**

SPORT



**DRITA BARAZON NË 'FADIL VOKRRI'
NDAJ INTER D'ESCALDES F. 11**

HIMNI MAQEDONAS PO, AI SHQIPTAR JO - SHQIPËRIA KRITIKON AKTIVITETIN KU MORI PJESË MICKOSKI

SHKUP, 21 GUSHT - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë ka kritikuar mosekzekutimin e himnit shqiptar në një aktivitet në Pustec të Korçës, ku mori pjesë kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski. Ministria e ka cilësuar këtë si një “mungesë serioze” dhe “shmangie nga rregullat e shkruara dhe të pushkruara të mirësjelljes dhe protokollit”. “Është gjithashtu themel i fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve të shëndosha ndërmjet njerëzve dhe shteteve tona”, thuhet në reagimin e Ministrisë së Jashtme shqiptare. Aktiviteti u zhvillua të enjten në Pustec dhe ishte i përqendruar te kultura maqedonase. Në të mori pjesë Mickoski, si dhe kryetari i Bashkisë së Pustecit dhe përfaqësues të tjerë lokalë.

Gjatë aktivitetit u ekzekutua himni kombëtar i Maqedonisë së Veriut, por jo ai i Shqipërisë. Ministria shqiptare tha se, ndonëse aktiviteti ishte organizuar nga një shoqatë lokale, prania e përfaqësuesve të lartë institucionalë dhe e të zgjedhurve vendorë i jepte atij një dimension publik. Pusteci është e vetmja bashki në Shqipëri ku komuniteti maqedonas përbën shumicën e popullsisë. Ajo shtrihet në qarkun e Korçës, në juglindje të Shqipërisë. Mickoski ka publikuar në rrjetet sociale pamje nga vizita e tij në Pustec dhe takimet me komunitetin maqedonas, por nuk ka reaguar publikisht deri tani për mosekzekutimin e himnit shqiptar dhe as për deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë.

Ai i cilësoi maqedonasit në Shqipëri si pjesë të “indit kombëtar”, duke bërë thirrje për bashkim rreth interesave kombëtare, të ardhmes së fëmijëve dhe respektit për historinë dhe dinjitetin e popullit. Vizita e Mickoskit në Pustec erdhi në një kohë kur përbërja dhe identiteti i komuniteteve maqedonase dhe bullgare në Shqipëri janë bërë temë debati, veçanërisht pas regjistrimit të popullsisë të vitit 2023. Regjistrimi evidentoi 2 281 persona që u vetëdeklaruan maqedonas, një rënie prej 59 për qind krahasuar me rreth një dekadë më parë. Në të njëjtin regjistrim, për herë të parë u regjistruan 7 057 persona që u vetëdeklaruan bullgarë. Komuniteti bullgar u njoh zyrtarisht në Shqipëri në



vitin 2017. Rezultati shkaktoi debat mes përfaqësuesve të dy komuniteteve mbi identitetin e popullsisë sllave në Shqipëri. Përfaqësuesit maqedonas nuk e pranuan rezultatin si pasqyrim real të madhësisë së komunitetit të tyre. Ata pretenduan se një pjesë e personave që tradicionalisht identifikoheshin

si maqedonas ishin regjistruar si bullgarë, duke e lidhur këtë me politikat e Bullgarisë për dhënien e pasaportave bullgare dhe, sipas tyre, me presione mbi banorët. Nga ana tjetër, përfaqësuesit bullgarë e konsideruan rezultatin një konfirmim të rëndësishëm të pranisë së komunitetit të tyre në Shqipëri.

SHBA-JA ZOTOHET SE DO TË VENDOSË “SANKSIONET MË TË ASHPRA” NË HISTORI NDAJ IRANIT

UASHINGTON, 21 GUSHT - Sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, tha se Shtetet e Bashkuara do të vendosin “sanksionet më të ashpra në histori” ndaj Teheranit dhe sugjeroi se planet për ta rritur presionin ekonomik nënkuptojnë se sulmet e mëdha ushtarake amerikane ndaj Iranit ka pak gjasa të rifillojnë së shpejti. “Është një goditje e dyfishtë. Kemi bllokadën [ndaj porteve iraniane] dhe do të kemi sanksionet më të ashpra në histori”, tha Bessent për rrjetin amerikan CNBC më 20 gusht. “Kjo do të funksionojë në Iran dhe ne do ta rrezojmë këtë regjim”. Komentet e Bessent erdhën një ditë pasi presidenti amerikan

Donald Trump kërcënoi Iranin me “luftë ekonomike dhe izolim në një shkallë të jashtëzakonshme” dhe paralajmëroi se çdo shtet që i ofron mbështetje Iranit do të përballlet me pasoja të rënda ekonomike. Përveç presionit ndaj Teheranit, “çdo shtet që lejon institucionet e tij financiare, bizneset, aeroportet ose entitetet qeveritare të ofrojnë çfarëdo lloj mbështetjeje jetike për Iranin, do të përballlet vetë me pasoja të jashtëzakonshme ekonomike”, shkroi Trumpi në platformën e tij “Truth Social” në orët e vona të 19 gushtit. “Ky do të jetë izolimi më i madh ekonomik i koordinuar në historinë e botës”, tha Bessent. “Dhe ne do t’u



themi [aleatëve] se jeni ose me ne, ose kundër nesh”. As Trumpi as Bessent nuk dhanë shumë detaje. Bessent i tha CNBC-së se më 24 gusht do të mbajë një konferencë për medie “për të folur saktësisht për atë që do të bëjmë”. Teksa çmimet e naftës u rritën më 20 gusht, Bessent tha se

beson se tregjet e naftës po “e keqinterpretojnë atë që nënkupton ky presion ekonomik. Nëse po ushtrojmë presionin maksimal ekonomik, atëherë kjo do të thotë se ka gjasa që të mos ketë rifillim të një operacioni kinetik në shkallë të gjerë”. “Kinetik”, në këtë kontekst, i referohet veprimit ushtarak. Paralajmërimet e Trumpit erdhën përmes një postimi në rrjetet sociale, në të cilin ai tha se Teherani ka dështuar të arrijë një marrëveshje me ShBA-në. Ky postim erdhi disa orë pasi Trumpi tha se negociatat me Iranin mund të rifillonin “në një pikë”, por u shpreh i kënaqur me gjendjen aktuale, duke thënë: “Për momentin, mendoj se

situata është shumë e mirë”. Këto zhvillime vijnë pas skadimit të periudhës 60-ditore të negociatave, të përcaktuar në bazë të një memorandumit mirëkuptimi mes ShBA-së dhe Iranit, të nënshkruar në qershor. Memorandumi synonte të krijonte një kornizë për përfundimin e konfliktit, parandalimin që Irani të kishte një armë bërthamore dhe rikthimin e lirisë së lundrimit përmes Ngushticës së Hormuzit. Shtetet e Bashkuara thonë se Irani e shkeli marrëveshjen e qershorit duke sulmuar anije tregtare në ngushticë gjatë korrik, duke nxitur rifillimin e veprimeve ushtarake amerikane. Lufta ShBA-Izrael kundër Iranit nisi më 28 shkurt.

SHBA-ja DËRGON NJË AEROPLANMBAJTËSË AFËR HORMUZIT

UASHINGTON, 21 GUSHT - Komanda Qendrore e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (CENTCOM) tha se aeroplanmbajtësja USS George Washington ka arritur në Detin Arabik. Deti Arabik lidh veriu e Gjirit të Omanit dhe më pas Ngushticën e Hormuzit. Ky dislokim vjen në kohën kur presidenti amerikan, Donald Trump, pretendon se Uashingtoni ka kontroll mbi Ngushticën e Hormuzit, teksa Irani thotë se rruga jetike ujore do të mbetet e mbyllur derisa ShBA-ja të zbatojë disa kushte të Republikës Islamike.



CENTCOM publikoi më 20 gusht një fotografi në X të ekuipazhit të aeroplanmbajtësës në kuvertë, në Detin Arabik, dhe tha se Grupi Sulmues i

Aeroplanmbajtësës George Washington kishte hyrë një ditë më parë në zonën e përgjegjësisë së komandës dhe do të operojë në rajon si pjesë e

dislokimit të planifikuar. The Wall Street Journal, CNN dhe NBC News raportuan se USS George Washington po dërgohej në Lindjen e Mesme për të zëvendësuar USS Abraham Lincoln. CNN, duke cituar një zyrtar amerikan, tha se rotacioni ishte planifikuar paraprakisht. Kjo lëvizje vjen në mes të raportimeve për mungesa ushqimesh dhe furnizimesh, probleme teknike, rënie të moralit dhe shqetësime për shëndetin mendor në bordin e aeroplanmbajtësës Lincoln, pas muajsh qëndrimi në det. Sekretari amerikan i Mbrojtjes,

Pete Hegseth, tha se raportimet për kushtet e vështira në bordin e anijes ishin “krejtësisht të shtrembëruara” dhe se ushtria po bënte gjithçka të mundur për të mbështetur ekuipazhin. Abraham Lincoln u largua nga San Diego në nëntor të vitit 2025 dhe ka qëndruar për më shumë se tetë muaj i dislokuar, përfshirë më shumë se 200 ditë radhazi pa hyrë në një port për të bërë një ndalesë substanciale. Dislokimet e aeroplanmbajtësëve amerikane zakonisht zgjasin rreth gjashtë deri në nëntë muaj, megjithëse mund të zgjaten gjatë kohës së luftës.

NATO: ÇDO VENDIM PËR RIHAPJEN E URËS MBI IBËR PËR VETURAT, T'I ADRESOJË NEVOJAT E TË GJITHA KOMUNITETEVE



PRISTINË, 21 GUSHT - NATO vlerëson se çdo vendim për rihapjen e mundshme të urës mbi lumin Ibër për trafik të veturave “duhet t’i adresojë nevojat e të gjitha komuniteteve lokale”. “KFOR-i, po ashtu, vazhdon ta ofrojë mbështetjen e nevojshme të sigurisë në mënyrë që përpjekjet diplomatike të Bashkimit Evropian të mund të lëvizin përpara”, tha një zyrtar i NATO-s për “Radion Evropa e Lirë”. Lidhur me tërheqjen graduale të trupave të misionit të NATO-s në Kosovë nga ura kryesore mbi Ibër ditë më parë reagoi ministri në detyrë për Punë të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, që e cilësoi lajm të mirë. Ai tha se, përveç largimit gradual të trupave të KFOR-it, do të shkurtohet edhe prania e Policisë së Kosovës mbi këtë urë. Sipas tij, ky proces do të jetë afatshkurtër dhe do të ofrojë garanci për të gjithë se “hapja e urës do të jetë një e mirë për të gjithë, pa pasur ndikim negativ ndaj askujt”. “Do të vijë momenti kur hapat e ardhshëm edhe do të bëhen publikë, edhe do të shihen ashtu siç po shihen sot. Dhe një

gjë e cila ka qenë brengë, por edhe simbol i ndarjes për 27 vjet, do të jetë një kujtim”, ka thënë Sveçla për transmetuesin publik të Kosovës më 10 gusht. Ura kryesore mbi Ibër aktualisht është e hapur vetëm për këmbësorë. Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar në korrik të vitit 2024 hapjen e saj edhe për qarkullimin e automjeteve, një nismë që shkaktoi tensione dhe reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Ndërkohë, ekzekutivi i Kosovës ka ndërtuar edhe dy ura të tjera pranë urës kryesore - një për këmbësorë dhe një për automjete - me synimin për ta lidhur Mitrovicën e Veriut me Mitrovicën e Jugut. “Radio Evropa e Lirë” kërkoi koment nga NATO lidhur me një letër që presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i dërgoi shefit të aleancës, Mark Rutte, duke i kërkuar që të ndalet zvogëlimi i pranisë së KFOR-it mbi këtë urë. Zyrtari i NATO-s tha se Rutte “është në kontakt të rregullt me presidentin Vuçiq”. Ai shtoi se misioni paqeruajtës i aleancës në Kosovë, KFOR, ka nisur tranzicionin gradual të

pranisë së saj të përhershme nga ura mbi lumin Ibër, “në linjë me përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë”. Sipas zyrtarit, kjo është pjesë e procesit të optimizimit të pozicionimit të KFOR-it i cili po zhvillohet me transparencë të plotë, duke shtuar se ky proces mund të zhbëhet, varësisht nga situata e sigurisë. Zyrtari i NATO-s theksoi se komandanti i misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, Ozkan Ulutash, mban kontakte me të gjithë homologët në Kosovë, me organizatat ndërkombëtare, por edhe me Forcat e Armatosura të Serbisë, teksa kujtoi edhe takimin e Ulutashit me përfaqësuesit e Listës Serbe më 11 gusht, ku u bisedua për çështjen e pranisë së misionit mbi lumin Ibër. KFOR-i, tha zyrtari, do të vazhdojë ta zbatojë mandatin që i buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe të ofrojë mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet. “KFOR-i do të ketë prani të dukshme në Mitrovicë të Veriut dhe të Jugut si dhe në veriun e Kosovës dhe vazhdon të kontribuojë që të ketë mjedis të

sigurt për të gjitha komunitetet”, tha zyrtari i NATO-s për “Radion Evropa e Lirë”.

Çfarë tha Vuçiqi?

Më herët gjatë ditës, Vuçiqi tha se i është drejtuar me një letër sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, duke i kërkuar ta ndalë zvogëlimin e pranisë në urën kryesore mbi Ibër në Mitrovicë të Veriut. “Sapo i dërgova një letër sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, dhe kërkoja që KFOR-i, në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së, ta ndalë terrorin ndaj serbëve, përndjekjen dhe arrestimet e tyre, rrënimin e shtëpive, si dhe hapjen e urës mbi Ibër”, shkroi Vuçiqi në “Instagram” më 20 gusht. “Besoj se vlerësimi i tij do të jetë se paqja dhe stabiliteti rajonal janë të një rëndësie të madhe”, shtoi ai. Më vonë gjatë mbrëmjes së 20 gushtit, Vuçiqi tha se pret që Rutte të përgjigjet ndaj letrës së tij “në një mënyrë apo në një tjetër” gjatë ditëve në vijim. Mitrovica, pas luftës së vitit 1999,

u nda në pjesën veriore, me shumicë serbe, dhe atë jugore, ku shumicën e përbëjnë shqiptarët. Sot ato funksionojnë si dy komuna të ndara. Megjithatë, që nga përfundimi i luftës, KFOR-i e ka mbajtur nën mbikëqyrje urën mbi Ibër, e cila ndër vite ka qenë pikë e përplasjeve ndëretnike. Sipas Vuçiqit, tërheqja e KFOR-it nga ura në këtë moment do të “krijonte kushte për një përballje përfundimtare me popullsinë serbe” në veri të Kosovës. Ai tha se autoritetet në Serbi do ta vazhdojnë “luftën politike me të gjitha mjetet e mundshme”, duke mos përjashtuar as mundësinë e thirrjes së një seance të posaçme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Vuçiqi tha se shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Serbisë, Millan Mojsilović, ka zhvilluar një bisedë “shumë të vështirë” dhe “të keqe” me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutash. Ura kryesore mbi lumin Ibër konsiderohet një nga pikat më të ndjeshme në aspektin e sigurisë në veri të Kosovës.

THAÇI: PRES LIRIMIN NGA ÇDO AKUZË

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pret të shpallet i pafajshëm nga të gjitha akuzat në procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. I pyetur se cilat janë pritjet e tij nga procesi gjyqësor, Thaçi ka qenë i prerë. “Pres lirimin nga çdo akuzë. Nuk kam çka t’u shtojë argumenteve të ekipeve mbrojtëse, si dhe fjalës sime përfundimtare në sallën e gjyqit”, ka thënë Thaçi në intervistën me shkrim për Debat Plus në RTV Dukagjini. Thaçi në këtë intervistë ka deklaruar se Serbia dhe Rusia synojnë ta delegjitimojnë dhe diskreditojnë shtetësinë e Kosovës, duke e lidhur këtë përpjekje edhe me procesin gjyqësor që po zhvillohet në Hagë.

PRISHTINË, 21 GUSHT - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se pret të shpallet i pafajshëm nga të gjitha akuzat në procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Aktgjykimi në rastin ndaj Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë të UÇK-së, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, pritet të shpallet më 16 shtator.

I pyetur se cilat janë pritjet e tij nga procesi gjyqësor, Thaçi ka qenë i prerë. “Pres lirimin nga çdo akuzë. Nuk kam çka t’u shtojë argumenteve të ekipeve mbrojtëse, si dhe fjalës sime përfundimtare në sallën e gjyqit”, ka thënë Thaçi në intervistën me shkrim për Debat Plus në RTV Dukagjini.

Thaçi është pyetur edhe nëse është përdorur për iniciativën për themelimin e Dhomave të Specializuara me seli në Hagë. Ai ka thënë se nuk është përdorur, por e ka kritikuar mënyrën se si, sipas tij, është përdorur vullneti i institucioneve të Kosovës. “Jo. Por nuk do të besoj se vullneti i të zgjedhurve të popullit të Kosovës do të keqpërdoret kaq brutalisht”, ka theksuar ish-presidenti.

Në intervistë, Thaçi është pyetur edhe për narrativën mbi të cilën Prokuroria e Specializuar ka ndërtuar pretendimet e saj. Sipas tij, kjo narrativë nis shumë më herët se periudha e luftës së Kosovës. “Çuditërisht, narrativa e pretendimeve të tilla fillon nga vitet e tetëdhjeta (atë kohë isha 11-12 vjeç) të lëvizjes së popullit të Kosovës për liri. Vazhdon deri në dhjetor 2000. Kulmon me Raportin e Dick Martyt, rrëfim ky i ndërtuar në bashkëpunim tanimë të konfirmuar mes zyrtarëve serb dhe rus në Këshillin e Evropës”, ka thënë Thaçi.

Ai ka folur edhe për mundësinë që procesi të ketë ndikim përtej rastit të tij. “Inkriminim për ndërkombëtarët nuk do të ketë. Por a do të ketë ndikim në ecurinë e drejtësisë ndërkombëtare? Sigurisht që do të ketë, dhe atë jo pak”, ka potencuar Thaçi.

Duke iu referuar akuzave të Zyrës së Prokurorit të Specializuar se kthimi i tij nga diaspora kishte

ndikuar në rritjen dhe masivizimin e UÇK-së, Thaçi ka thënë se veprimet e tij ishin pjesë e një angazhimi më të gjerë të shqiptarëve nga diaspora. “ZPS-ja më akuzon tani se kthimi im nga diaspora ndikoi në rritjen dhe masivizimin e UÇK-së. Bëra atë që shumë të rinj shqiptar nga diaspora bënë në javët dhe muajt e rezistencës. Unë nuk e solla rezistencën në valixhe nga perëndimi në Kosovë”, ka thënë ish-presidenti Thaçi në intervistën e tij dhënë për Debat Plus.

Thaçi: Synimi serbo-rus është të diskreditohet projekti i shtetit të Kosovës

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se Serbia dhe Rusia synojnë të delegjitimojnë dhe diskreditojnë shtetësinë e Kosovës, duke e lidhur këtë përpjekje edhe me procesin gjyqësor që po zhvillohet në Hagë.

Në intervistën e tij të fundit para shpalljes së aktgjykimit në rastin ndaj tij dhe ish-krerëve të tjerë të UÇK-së, dhënë ekskluzivisht për Debat Plus, Thaçi ka thënë se pas dështimit të përpjekjeve të Serbisë për ta delegjitimuar pavarësinë e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas tij, fokusi është zhvendosur drejt Këshillit të Evropës. “Liria dhe ndërtimi i pavarësisë së Kosovës ishte e pakapërdishme për Serbinë dhe Rusinë. Pasi dështuan ta delegjitimojnë pavarësinë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ata iu drejtuan Këshillit të Evropës. Synimi serbo-rus është i qartë: të diskreditohet projekti i shtetit të Kosovës”, ka deklaruar Thaçi.

Duke folur për procesin gjyqësor në Hagë, Thaçi ka thënë se Prokuroria Speciale po u jep peshë dëshmimeve që ai i konsideron të fabrikuara nga periudha e regjimit të Slobodan Millosheviqit. Në të njëjtën kohë, ai ka thënë se Prokuroria po i anashkalon dëshmitë e zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë, të cilët sipas tij kanë pasur rol të drejtpërdrejtë në zhvillimet e



Kosovës gjatë luftës dhe pas saj. “Prokuroria po lartëson dëshmitë e fabrikuara nga epoka e regjimit të Millosheviqit; në anën tjetër mohan dëshmitë dhe argumentet e zyrtarëve të lartë të SHBA-së, NATO-s, Britanisë së Madhe, OKB-së, OSBE-së dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare. Zyrtarët ndërkombëtarë ishin sytë dhe veshët e Perëndimit në Kosovë”, ka thënë ai.

Thaçi ka folur edhe për dëshmitë e zyrtarëve ndërkombëtarë në sallën e gjyqit, duke thënë se prania e tyre në proces, sipas tij, tregon një obligim moral për të dëshmuar atë që kanë parë dhe përjetuar gjatë periudhës së luftës në Kosovë. “Ata, erdhën me lejen e qeverive të tyre. Nuk është e lehtë që këto personalitete të spikatura të ulen në një sallë të tillë gjyqi. Erdhën vullnetarisht dhe e deklaruan vetë arsyen e tyre për të dëshmuar. Kuptova se ata po e shihnin se diçka e

gabuar, po ndodhte në këtë proces. Po ndienin obligim moral të thoshin të vërtetën”, ka deklaruar Thaçi.

Thaçi me porosi nga Haga për krizën politike në Kosovë: Pozita dhe opozita duhet të ulen në një tryezë

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë thirrje për një marrëveshje të gjerë politike ndërmjet pozitës dhe opozitës në Kosovë.

Thaçi në intervistën e tij në Debat Plus ka kërkuar që partitë politike, pavarësisht nëse janë në pushtet apo opozitë, të ulen në një tryezë dhe të arrijnë pajtim për disa çështje strategjike. Ai ka përmendur si prioritetet sigurinë nacionale, reformat demokratike, reformat elektorale, politikën e jashtme,

marrëveshjet ndërkombëtare dhe investimet në mbrojtje. “Mendoj se politika kosovare, pozitë dhe opozitë, duhet të ulet në një tryezë, të diskutojë dhe të pajtohet rreth disa zotimeve të përbashkëta: sigurisë nacionale, reformave demokratike, reformat elektorale (zgjedhja e presidentit drejtpërdrejt nga populli, si mundësi për evitimin e krizave institucionale), politikës së jashtme, marrëveshjeve ndërkombëtare, investimeve në mbrojtje, integritimit në NATO dhe BE, raporteve speciale me SHBA-në, pastaj me Shqipërinë dhe eventualisht dialogut me Serbinë, etj”, ka thënë Thaçi. Kjo është intervista e fundit e Thaçit para shpalljes së aktgjykimit, ndërsa më 16 shtator, në orën 10:00, pritet të shpallet aktgjykimi i shkallës së parë në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit në Hagë.

TAHIRI I PDK-SË: VDEKJA E PUNËTORËVE TË KEK-ut NË VENDIN E PUNËS, DËSHTIM INSTITUCIONAL

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 GUSHT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Arian Tahiri, e ka akuzuar qeverinë për mungesë reagimi dhe mbikëqyrjeje të kushteve të punës në institucionet dhe ndërmarrjet publike, pasi dy punëtorë të KEK-ut humbën jetën brenda tri ditësh si pasojë e lëndimeve të marra në vendin e punës.

Tahiri, në një konferencë për medie, duke kritikuar për dështim institucional, kërkoi që organet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete menjëherë. “Më 20 gusht Arbenit Ahmeti humbi jetën duke transportuar kabllo 6 kV. Më 16 gusht, vetëm katër ditë më herët, Haxhi Gojnovci, teknik i xehetarisë, mbeti i vdekur pranë ekskavatorit. Më 15 korrik Milazim Binaku ndërroi jetë në QKUK si pasojë e lëndimeve të marra më 8 korrik në Fabrikën e Pajimeve Xehtare në Palaj. Më 27 shkurt Migjen Sadiku ndërroi jetë në hapësirat e Termocentralit ‘Kosova B’. Pas secilit prej këtyre emrave është një nënë që pret, një bashkëshorte që mbetet vetëm, fëmijë që pyesin pse babai i tyre nuk u kthye më. Janë punëtorë që shkuan në punë për ta siguruar bukën e gojës për

familjet e tyre dhe humbën jetën duke bërë punën e tyre”, shtoi ai.

Tahiri rikujtoi se qeveria, e cila e ka centralizuar sistemin e inspektimeve, duke krijuar Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm brenda Zyrës së Kryeministrit, por kur ndodhin raste të tilla ata ikin nga përgjegjësia. “Qeveria nuk mund të jetë njëkohësisht menaxhuese dhe mbikëqyrëse e ndërmarrjeve publike dhe, në fund, të sillet sikur nuk ka asnjë përgjegjësi. Si është e mundur që kur flitet për rritje të prodhimit apo për progres, dalin dhe shprehin krenari, ndërsa në raste të tilla fshihen nëpër xhipa të zinë e prapa perdeve të pushtetit? Kur këto vdekje ndodhin në një ndërmarrje publike, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të shtetit, ato bëhen dëshmi e një dështimi institucional. Nëse shteti nuk arrin të mbrojë jetën e punëtorëve të vet, si mund të pretendojë se mbron jetën dhe të drejtat e punëtorëve në sektorin privat?”, tha Tahiri.

Tahiri shprehu indinjatën që siguria e punëtorëve nuk garantohej me deklarata ngushëllimi, por duhet të garantohej me standarde të qarta, me inspektime të rregullta dhe të pavarura, me parandalim, me zbatim të ligjit dhe me



llogaridhënie, para se dikush tjetër ta humbë jetën. “Në pamundësi që këto raste t’i ngremë në Kuvendin e Kosovës dhe në komisionet parlamentare, nga këtu i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës, Ministrisë përkatëse,


Inspektoratit të Punës dhe vetë Korporatës Energjetike të Kosovës që të përkujdesen dhe t’i mbështesin financiarisht familjet e viktimave; të zhvillojnë menjëherë inspektime të plota dhe të pavarura; të

identifikojnë dhe eliminojnë rreziqet në vendet e punës; të rrisin masat e sigurisë dhe mbrojtjes për punëtorët; dhe mbi të gjitha, të garantojnë që tragjedi të tilla të mos përsëriten”, tha ai.

PROCESI I PROKURIMIT PËR MIRËMBAJTJEN E AUTOUDHËVE NUK U REALIZUA PLOTËSISHT NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PROKURIMIT PUBLIK

PRISHTINË, 21 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës “Zbatimi i procedurave të prokurimit për mirëmbajtjen rutinore dhe dimërore të Autoudhëve A7 dhe A6 të Republikës së Kosovës për vitet 2025 - 2028”.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nuk kishte arritur të siguronte që procesi i prokurimit të realizohej plotësisht në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminimit. “Aktiviteti i prokurimit me vlerë të parashikuar prej 15.9 milionë euro për 36 muaj, ishte iniciuar vetëm 36 ditë para skadimit të kontratave ekzistuese, prandaj afati për dorëzimin e ofertave ishte shkurtuar nga 40 në 21 ditë. Megjithatë, ky përshpejtim nuk kishte arritur rezultatin e synuar, pasi hapja e ofertave ishte shtyrë pesë herë dhe procedura ishte zgjatur për rreth pesë muaj për shkak të kërkesave për rishqyrtim, ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe korrigjimeve në dosjen e tenderit”, thuhet në komunikatën e ZKA-së. Për shkak se procedura e hapur



nuk ishte përmyllur para fillimit të sezonit dimëror, Ministria kishte përdorur procedura të negociuara për të siguruar vazhdimësinë e mirëmbajtjes së autoudhëve. Përmes katër kontratave gjashtëmujore të negociuara, deri në korrik 2026 ishin paguar rreth 2.8 milionë euro. Sipas ZKA-së, përdorimi i këtyre procedurave kishte kufizuar konkurrencën dhe kishte ofruar më pak transparencë krahasuar me procedurën e hapur. “Procesi i auditimit ka evidentuar mangësi edhe në vlerësimin e ofertave, ku Komisioni i Vlerësimit në disa raste nuk kishte kërkuar

sqarimet e nevojshme lidhur me disa paqartësi teknike, formale ose metodologjike, sqarimi i së cilave nuk do ta ndryshonte përmbajtjen substanciale të ofertës. Kjo kishte rritur rrezikun që procesi i vlerësimit të mos siguronte trajtim plotësisht të barabartë të operatorëve ekonomikë”, thuhet në komunikatën e ZKA-së. Gjithashtu auditimi ka konstatuar se Ministria nuk kishte analizuar të gjitha kombinimet e mundshme të ofertave të përgjegjshme për katër llojet. “Kombinimi alternativ i identifikuar nga auditimi do të kishte rezultuar

me një çmim të përgjithshëm për njësi rreth 15% më të ulët sesa kombinimi i kontraktuar. Si pasojë, Ministria nuk kishte arritur të siguronte kombinimin më ekonomik të ofertave dhe kishte humbur mundësinë për realizimin e më shumë shërbimeve brenda buxhetit të përcaktuar. Dallime të theksuara janë evidentuar edhe ndërmjet çmimeve të ofertuara dhe çmimeve referente të Ministrisë. Në Llotin e tretë, 77 nga 113 pozicione, apo 68% e tyre, ishin ofertuar me çmime mbi 90% më të ulëta se çmimet referente. Në disa raste, pozicione të përlogaritura nga Ministria me 180 apo 240 euro ishin ofertuar me vetëm 0.10 euro për njësi. Për këto devijime nuk ishte kryer analizë e dokumentuar dhe nuk ishin kërkuar sqarime të mjaftueshme nga operatorët ekonomikë, duke rritur rrezikun për vështirësi gjatë zbatimit dhe menaxhimit të kontratave”, vlerësohet në komunikatën e ZKA-së.

Në aspektin e integritetit të procesit, auditimi ka identifikuar rrethana që potencialisht mund të paraqisnin konflikt interesi meqë kryesuesi i Komisionit të Vlerësimit kishte pasur angazhim profesional të

mëhershëm me operatorin ekonomik që ishte shpallur fitues në njërin prej lloteve. “Ministria nuk kishte bërë vlerësimin apo trajtimin e këtyre rrethanave dhe rasti nuk ishte referuar tek autoriteti kompetent, duke krijuar pasiguri lidhur me paanshmërinë dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimit”, theksohet në komunikatë.

Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, theksoi se planifikimi në kohë i procedurave, përcaktimi i kriterëve të qarta dhe vlerësimi i dokumentuar i ofertave janë të domosdoshme për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe vlerë më të mirë për paratë publike. Spanca tha se ministria duhet t’i shtojë kontrollet në të gjitha fazat e prokurimit, veçanërisht në analizimin e çmimeve, përzgjedhjen e kombinimit më ekonomik të ofertave si dhe parandalimin dhe menaxhimin e rrethanave që mund të krijojnë konflikt interesi.

Me qëllim të përmirësimit të procesit të prokurimit dhe përdorimit më efikas të fondeve publike, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka dhënë shtatë rekomandime për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit.

PSE DUHET TË BËJMË NJË FILM NDËRKOMBËTAR PËR SKËNDERBEUN



Ben BLUSHI

Më shumë se 50 milionë euro fitime i ka sjellë filmi Odisea Greqisë gjatë këtij sezoni turistik.

Plazhet ku janë xhiruar skenat e filmit janë plot, biletat e kinemave janë stërshitur, veprat e Homerit janë ribotuar në qindra gjuhë, kurse ishujt grekë janë mbushur me turistë që sillen si Odisea majë varkave me vela.

Por përveç fitimeve, filmi i Kristofer Nolan ka rritur vetëbesimin e popullit grek i cili në vitin 2008 kreu vetëvrasjen financiare më të përgjakshme të kohëve moderne.

Atëherë kur grekët kishin më shumë nevojë, Odisea doli nga deti dhe i fshiu plagët që politikanët i shkaktuan vendit të tyre.

Në dy muajt e fundit çdo faqe instagrami, çdo revistë autoritare dhe çdo mendje influente e këtij planeti ka përdorur kutin e lashtësisë greke për t'ju treguar ndjekësve të vet çfarë është e drejtë dhe çfarë nuk është.

Duket sikur Greqia është bërë prapë qendra e botës.

Ajo ka rilindur vetëm nga një film duke zbuluar mallin më të rrallë të kohës që jetojmë: entuziazmin.

Duke parë efektin që kjo ngjarje ka pasur mbi popullin grek shumë shtete kanë menduar t'ia japin borxh heronjtë e tyre Hollivudit.

Me pak fjalë t'i luten të bëjë filma për ta.

Kush nuk do donte një film si Odisea për një viking me fytyrën e futbollistit Haaland që shkon në Amerikë me lundrën e muskujve, apo për ndonjë eksplorator sypatrembur që zbulon kontinente të reja duke përdorur pasqyrat e oqeanit si semafor.

Norvegjezët dhe portugezët me

siguri po mbajnë radhë në Hollywood, pa folur për tarzanët e Indisë dhe samurait e Japonisë. Odisea i ka hutuar të gjithë.

Ai provoi se bota e sotshme ka nevojë për heronj të cilët mund të zbusin vështirësitë e jetës së përditshme.

Popujt gjejnë më shumë frymëzim tek heronjtë e dikurshëm sesa tek futbollistët e pasur, modelet anoreksike dhe polikanët e mërziutshëm.

Në këto kushte dhe ne duhet të bëjmë llogaritë tona.

Ne nuk kemi një Odise, por kemi një legjendë që mund të kthehej në një super film me përmasa ndërkombëtare.

Ky është pa dyshim Skënderbeu. Ai nuk ka famën e heronjve të Trojës dhe nuk përfaqëson udhëtarin që çan detet për t'u kthyer te gruaja, por në ditët kur jetojmë simbolika e Skënderbeut është shumë e fortë.

Ndryshe nga Odisea, Skënderbeu nuk ishte pushtues por mbrojtës.

Njëlloj si në kohën e tij, turma të egra po kapërcejnë dete, furtuna dhe dallgë për të arritur në brigjet e Evropës.

Ata nuk vijnë me ushtri, as me armë por vijnë si hordhi.

Në rrëmujë e sipër rrëzojnë qeveri, heqin njerëz nga puna, ndryshojnë median dhe debatin e përditshëm bashkë me zakonet e vendasve.

Qyteti spanjoll i Ceutës është fotografia e së nesërmes.

Brenda një dite aty shkuan me not 70 mijë marokenë për t'u kujtuar 450 milionë evropianëve çfarë do të ndodhë kur emigrantët e paligjshëm të bëhen 70 milionë.

Natyrisht Skënderbeu nuk e ndalon dot këtë dyndje, por as Odisea nuk bind dot miliona evropianë të divorcuar të kthehen te gratë.

Mirëpo simboli i heroit tonë kombëtar është më i nevojshëm se kurrë për evropianët e dëshpëruar.

Skënderbeu arriti para 600 vitesh atë që ata nuk po e arrijnë dot sot.

Ai pengoi hordhitë të merrnin Vjenën, Romën dhe Parisin.

Skënderbeu nuk kishte polici, as dronë, as nëndetëse dhe as radarë.



Kishte vetëm nja dhjetë mijë shqiptarë që e ndiqnin me sy mbyllur sikur të ishte perëndi. Ky është filmi që i duhet Evropës sot.

Historia e Skënderbeut, Mbajtësit të Hordhive, Penguesit të Madh.

Kushdo që mendon se ky film do ishte shumë i kushtueshëm e ka gabim.

Ja vlen të sakrifikosh një rrugë dhe tre ura për t'i dhënë një regjisorit të madh ndërkombëtar një buxhet të përafërt me Odisenë.

Populli do ishte shumë i lumtur të paguante nga taksat e veta, ndërkohë që një fushatë mbarëkombëtare për të mbledhur fonde për filmin Skënderbeu do mobilizonte 7 milionë shqiptarë të shpërndarë në gjithë botën.

Sikur secili të dhuronte mesatarisht 10 dollarë, do të bëheshin 70 milionë dollarë, pa folur për qindra oligarkë që do kishin mundësi të dëshmonin patriotizmin e tyre estetik në

këtë ankand krenarie.

Me siguri ata do shkëlqenin si tepsi bakri kur të shikonin emrin e tyre në listën e producentëve të një filmi hollivudian që me një kombinim donacionesh publike dhe private do mbledhte lehtësisht 150 milionë dollarë.

Odisea i Nolan ka kushtuar 250 milionë dhe deri tani ka arkëtuar më shumë se 1 miliard. Ky do ishte filmi i dytë për Skënderbeun.

I pari është krijuar në vitin 1953 nga rusët.

Enver Hoxha ia kërkoi si nder Stalinit që vuri vetëm një kusht : rolin e Skënderbeut do ta luante një shoku i tij me emrin Akaki Horava, që për fat të keq ishte tullac.

I destinuar të barazojë llogaritë mes superfuqive, Skënderbeu që ishte sovjetik herën e parë, mund të jetë amerikan herën e dytë.

Në fund të fundit kjo është natyra e tij e dyfishtë: edhe i

krishterë edhe mysliman, edhe Gjergj edhe Skënder, edhe lindor edhe perëndimor.

Në këtë mënyrë qeveritë tona do mburreshin me të drejtë se lanë pas monumentin kulturor më të madh të të gjitha kohëve. Por përveç një Skënderbeu të luajtur nga një aktor i madh modern, përmes këtij filmi do fitonim edhe shumë heronj që koha i ka tretur pa ju krijuar një portret që mbahet mend.

Magjia e kinemasë do krijonte fytyrën e vuajtur të Donika Kastriotit që priti kthimin e Skënderbeut nga luftërat më gjatë se Penelopa, të Mamicës inteligjente që është zhubrosur aq keq nga silikoni elektoral i mitingjeve tona, të Hamzait të përkëdhelur që tradhtoi xhaxhanë e vet për t'u bërë mbret dhe të Aranit Komnenit, Agamemnonit tonë me nëntë vajza që e kishte Skënderbeun dhëndër.

Ne nuk i kemi imazhet e tyre në kujtesën tonë.

Hollywoodi mund të na i krijojte me galerinë e aktorëve të mëdhenj.

Atëherë kinematë e botës do tejmbusheshin, Kruja do të bëhej qyteti më i vizituar mbi tokë, vendet ku ka luftuar Skënderbeu do ktheheshin në pelegrinazh dhe Shqipëria do ju dukej njerëzve si një tokë heronjsh, kurse ne do kishim Skënderbeu Game of Thrones, muzeun më të madh të historisë sonë në një film.

Por përfitimet e këtij projekti nuk janë vetëm financiare.

Ne kemi nevojë për Skënderbeun, sa ç'kanë nevojë grekët për Odiseun.

Shqiptarët jetojnë më mirë se 100 vjet më parë dhe shumë më mirë se 30 vjet më parë, por prapë nuk jetojnë mirë.

Shembujt pozitivë janë shumë pak, modelet e këqija triumfojnë kudo.

Nëse je i mirë humb, nëse je i keq fiton.

Kush beson se jeton mirë si shqiptar, jeton keq si evropian. Prandaj kemi nevojë më shumë se kurrë për Skënderbeun.

Për të na dhënë pak besim.

Pak vetëbesim se nuk jemi një popull kamerieresh që i nxjerrin thikën turistëve në plazh, por jemi një popull heronjsh.

SHKK forcon standardet e sjelljes, sigurisë dhe rehabilitimit në institucionet korrektuese

Prishtinë, 21 gusht- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, ka nënshkruar Kodin e Mirësjelljes së Personave të Burgosur në Institucionet Korrektuese dhe Udhëzuesin për zbatimin e kriterëve dhe sqarimin e faktorëve për shfrytëzimin e pushimit jashtë institucionit korrektues për personat e dënuar.

Të dyja këto akte synojnë të forcojnë standardet e sigurisë, rendit dhe disiplinës në institucionet korrektuese, duke krijuar një qasje më të

qartë dhe të standardizuar në menaxhimin e personave të burgosur dhe në proceset që lidhen me rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.

Kodi i Mirësjelljes përcakton rregullat dhe standardet e sjelljes që duhet të respektohen nga personat e dënuar dhe të paraburgosur gjatë gjithë qëndrimit të tyre në institucionet korrektuese. Ai vendos theks të veçantë në respektimin e rendit dhe disiplinës, komunikimin korrekt me stafin dhe personat e tjerë të burgosur,



shmangien e dhunës, kërcënimeve dhe konflikteve, respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve, si dhe bashkëpunimin në proceset e sigurisë, rehabilitimit dhe riintegritit.

Ndërsa Udhëzuesi për pushimet jashtë institucionit përcakton mënyrën e zbatimit dhe vlerësimin e kriterëve për shfrytëzimin e këtij beneficioni.

Vlerësimi bëhet në mënyrë individuale, objektive dhe profesionale, duke u bazuar në të dhëna konkrete dhe të

verifikueshme, si dhe në vlerësimin e rrezikut.

Në këtë proces merren parasysh vepra penale për të cilën personi është dënuar, qëndrimi ndaj veprës penale, sjellja gjatë vuajtjes së dënimit, respektimi i rregullave të institucionit, pjesëmarrja në programet rehabilituese, niveli i përgjegjësisë dhe besueshmërisë, rreziku për sigurinë publike, mundësia e përsëritjes së veprës penale, historiku i tentimeve për arratisje, si dhe rrethanat dhe mbështetja familjare.

Arsenal armësh pranë lokacioneve të dyshuara të varrezave masive në Zubin Potok

PRISHTINË, 21 GUSHT - Një arsenal armësh, municionesh, uniformash dhe pajisjesh ushtarake është gjetur në fshatrat përreth Kalludrës së Zubin Potokut, në zonën ku gjatë javëve të fundit janë zbuluar tri lokacione të dyshuara të varrezave masive. Policia e Kosovës ka publikuar pamje nga operacionet e zhvilluara në 48 lokacione të ndryshme në komunën e Zubin Potokut, gjatë të cilave

janë konfiskuar armë, municion, pajisje të ndryshme ushtarake dhe dëshmi të tjera relevante. Sipas autoriteteve, në tri lokacionet e dyshuara për varreza masive janë gjetur mbetje kockore, të cilat dyshohet se u përkasin të paktën 23 personave. Këto veprime janë ndërmarrë në kuadër të hetimeve për rastin "Krime të Luftës ndaj Popullatës Civile".

Në lidhje me këtë rast, nën dyshimin për kryerjen e veprës penale "Krime lufte kundër popullsisë civile", po hetohen tre persona me inicialet J. R., M. J. dhe M. B., të cilët ndodhen në masën e paraburgimit. Policia ka bërë me dije se veprimet e mëtejshme lidhur me rastin po ndërmerren në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe organet e drejtësisë.



OHTK DHE OVLUÇK NËN SHKRUANJË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR MBËSHTETJEN E KATEGORIVE TË LUFTËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 GUSHT - Oda e Hotelierisë dhe Turizmit e Kosovës (OHTK) dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK) kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me synim mbështetjen e veteranëve, invalidëve të luftës, familjeve të dëshmorëve dhe anëtarëve të organizatës. Marrëveshja parasheh mundësi për akomodimin e delegacioneve, organizimin e trajnimeve, konferencave dhe aktiviteteve të përbashkëta. Gjatë ceremonisë u diskutuan edhe sfidat me të cilat përballen kategoritë e dala nga lufta. Kryetari i OHTK-së, Hysen Sogojeva, tha se memorandum synon të ofrojë mbështetje konkrete për

OVLUÇK-në, përfshirë akomodimin e delegacioneve nga jashtë dhe përfshirjen e veteranëve, familjeve të dëshmorëve dhe fëmijëve të tyre në trajnime profesionale. Sogojeva theksoi se OHTK-ja, përmes bizneseve anëtare dhe projekteve të saj, mund të ofrojë mundësi për akomodim në rajone të ndryshme të Kosovës si dhe për organizimin e trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta. Ndërkaq, kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, tha se memorandum është mirëpritur nga organizata dhe se çështja e kategorive të dala nga lufta duhet të jetë përgjegjësi e përbashkët e shoqërisë dhe institucioneve. Gucati kritikoi qeverinë për, siç tha, mungesën e mbështetjes ndaj veteranëve dhe kategorive të tjera të luftës. "Me këtë qeveri nuk



kemi raporte, as bisedime, as takime. Për gjashtë vjet asnjë kërkesë nuk është realizuar nga kjo qeveri", tha Gucati. Ai përmendi edhe rastet e veteranëve që po trajtohen

jashtë vendit, duke thënë se aktualisht 67 veteranë janë me kancer, ndërsa 24 prej tyre po trajtohen në Turqi, ndërsa të tjerë në vende të ndryshme të Evropës dhe në Kosovë.

Sipas Gucatit, institucionet kanë obligim ligjor për të ofruar mbështetje shëndetësore për veteranët, invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve.

AKB-ja: PRODHUESIT NUK JANË 'PRODHUES TË SË KEQES', ATA E MBAJNË GJALLË EKONOMINË E KOSOVËS



PRISHTINË, 21 GUSHT - Aleanca Kosovare e Bizneseve ka dënuar gjuhën fyese dhe përcmuese ndaj prodhuesve vendorë të cilët protestuan për problemet reale të ekonomisë dhe kërkuar funksionalizimin e institucioneve. AKB-ja ka vlerësuar se është e papranueshme që deputetët e Kuvendit t'i etiketojnë prodhuesit si "prodhues të Zajednicës", "prodhues të së

keqes" apo "prodhues të KEQ". AKB-ja ka vlerësuar se prodhuesit nuk janë prodhues të së keqes. Ata janë prodhues të vendeve të punës, pagave, tatimeve, investimeve dhe mirëqenies së qytetarëve. AKB-ja i bën thirrje skenës politike t'i ruajë dhe ta ndalojë etiketimin dhe përdorimin e bizneseve e prodhuesve si pjesë të përplasjeve politike. Prodhuesi ka të drejtë të protestojë, të kërkojë

institucione funksionale dhe të kritikojë çdo qeveri, pa u sulmuar politikisht. "Mos i ndani prodhuesit në 'tanët' dhe 'të tyre'. Prodhuesit janë të Kosovës dhe interesat e tyre janë interesat e ekonomisë së Kosovës", thekson AKB-ja. AKB-ja ka theksuar se do t'i mbrojtë me vendosmëri prodhuesit vendorë ndaj çdo gjuhe denigruese pavarësisht se nga cila parti politike vjen ajo.

Gucati kritikon qeverinë Kurti: Asnjë kërkesë e veteranëve nuk është realizuar

PRISHTINË, 21 GUSHT - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK), Hysni Gucati, ka kritikuar qeverinë Kurti për, siç ka thënë, mungesën e bashkëpunimit dhe mosrealizimin e kërkesave të veteranëve të luftës. Pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit

ndërmjet Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK) dhe OVLUÇK-së, Gucati tha se organizata që drejton nuk ka pasur takime apo diskutime me qeverinë në detyrë. Ai u ndal veçanërisht të çështja e trajtimit shëndetësor të veteranëve, duke thënë se

aktualisht 67 prej tyre janë të prekur nga kanceri, ndërsa 24 po marrin trajtim në Turqi. Sipas tij, një pjesë e veteranëve po trajtohen në vende të tjera evropiane dhe në Kosovë. "Shoqëria dhe institucionet e vendit e kanë obligim për t'u kujdesur për këto kategori të

luftës. Është e vërtetë se ne nuk kemi kërkesa të mëdha as në qeveri. Megjithatë, dua të jap kritika në start se me këtë qeveri nuk kemi asnjë raport, bisedime dhe as takime. Deri më sot, që gjashtë vjet, asnjë kërkesë nuk është realizuar nga kjo qeveri", tha ai.



AKP-ja nxjerr në shitje 258 prona në të gjithë Kosovën

PRISHTINË, 21 GUSHT - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka shpallur shitjen e re të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim në kuadër të Shitjes së Aseteve me Likuidim nr. 75 (ShAL 75).

Në këtë valë të shitjeve janë përfshirë gjithsej 258 asete, të shpërndara në të gjashtë rajonet e Kosovës. Asetet përfshijnë njësi bujqësore, prona rezidenciale, objekte komerciale, depo dhe lokale afariste. Sipas AKP-së, një pjesë e pronave kanë tokë të

përshtatshme për bujqësi intensive dhe pemëtari, ndërsa të tjerat ofrojnë mundësi për zhvillim të banimit, investime afariste, logjistikë dhe magazinim. “Kjo valë e shitjeve synon të nxisë zhvillimin ekonomik përmes krijimit të mundësive konkrete për investime në bujqësi, banim, tregti dhe shërbime”, thuhet në njoftimin e AKP-së.

Pronat e ofruara kanë sipërfaqe të ndryshme, duke filluar nga njësi të vogla të përshtatshme

për investitorë individualë, deri te prona më të mëdha me potencial për zhvillim rural, agrobiznes dhe projekte banimi. Ofertat e mbyllura për asetet në shitje duhet të dorëzohen më 9 shtator 2026, në “Sallën e konferencave - Hoteli Grand” në Prishtinë, nga ora 10:00 deri në 12:00. Ofertat duhet të shoqërohen me depozitën dhe tarifën për paraqitjen e ofertës sipas kushteve të përcaktuara për secilën njësi. Hapja e ofertave do të bëhet po

atë ditë, duke filluar nga ora 12:30.

AKP-ja ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe palët e interesuara mund të marrin informata shtesë dhe t'i vizitojnë pronat që janë në shitje. “AKP fton të gjithë të interesuarit, individë, biznese, diasporë dhe investitorë të huaj, që të aplikojnë përmes një procesi transparent dhe të mbikëqyrur dhe të mos e humbin këtë mundësi për të investuar në prona me vlerë dhe me



potencial të madh zhvillimor”, thuhet në njoftim.

Për informata më të hollësishme dhe për kushtet e pjesëmarrjes në shitje, AKP-ja i ka udhëzuar të interesuarit të kontaktojnë institucionin ose t'i konsultojnë informacionet e publikuara në faqen zyrtare të Agjencisë.

QARKULLIMI NË SEKTORIN E SHËRBIMEVE BIE 0,37 % NË QERSHOR, RITEN PUNËSIMI DHE FONDI I PAGAVE

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 GUSHT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat Afatshkurtra të Shërbimeve për muajin qershor 2026. Sipas ASK-së, në qershor 2026 indeksi i qarkullimit në sektorët e shërbimeve shënoi rënie prej 0,37-përqindësh krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2025. Sipas aktiviteteve ekonomike, rritje të qarkullimit u shënuar te veprimtaritë botuese, prodhimi audiovizual, transmetimi, telekomunikimi, programimi kompjuterik dhe shërbimet e informacionit 11,37 për qind; te baret dhe restorantet 10,79 për qind; te veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike 7,28 për qind si dhe te hotelet 6,60

për qind. Ndërkaq, rënie u regjistruar te veprimtaritë administrative dhe mbështetëse 8,26 për qind si dhe te transporti dhe magazinimi 15,51 për qind.

Rritet numri i të punësuarve

Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorët e shërbimeve në qershor 2026 u rrit 3,27 për qind krahasuar me qershorin e vitit 2025. Rritja më e madhe u regjistruar te baret dhe restorantet, 6,13 për qind. Pas tyre renditen veprimtaritë botuese, prodhimi audiovizual, transmetimi, telekomunikimi, programimi kompjuterik dhe shërbimet e informacionit me 3,61 për qind; veprimtaritë profesionale,

shkencore dhe teknike me 3,42 për qind; transporti dhe magazinimi me 2,48 për qind; hotelet me 0,67 për qind; si dhe veprimtaritë administrative dhe mbështetëse me 0,49 për qind.

Fondi i pagave rritet 14,83 për qind

Sipas ASK-së, indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve në sektorët e shërbimeve shënoi rritje prej 14,83-përqindësh në qershor 2026 krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak. Rritja më e lartë u regjistruar te baret dhe restorantet 21,33 për qind, ndërsa pasojnë veprimtaritë botuese, prodhimi audiovizual, transmetimi, telekomunikimi, programimi kompjuterik dhe shërbimet e



informacionit 14,31 për qind. Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike shënuan rritje prej 14,30-përqindësh, veprimtaritë administrative dhe mbështetëse 13,21 për qind, hotelet 12,87 për qind, ndërsa transporti dhe magazinimi 11,75

për qind. Të dhënat e ASK-së tregojnë kështu se, përkundër rënies së lehtë të qarkullimit në sektorin e shërbimeve, gjatë qershorit është shënuar rritje në numrin e të punësuarve dhe në fondin e pagave dhe mëditjeve.

ZKA-ja SHËNON PËRPARIM TË DUKSHËM NË ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE DHE FORCON BESUESHMËRINË INSTITUCIONALE

PRISHTINË, 21 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka shënuar përparim të dukshëm në zbatimin e rekomandimeve të rishikimit kolegjial të vitit 2023, duke forcuar qeverisjen e brendshme, metodologjinë e auditimit, sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e raportimit. Ky është vlerësimi i Raportit Vijues të Rishikimit Kolegjial (Peer Review), i realizuar nga SIGMA.

Sipas raportit, ZKA-ja po konsolidohet institucion supremi auditimit gjithnjë e më i besueshëm dhe me funksionim të mirë, duke evidentuar përparim të rëndësishëm në forcimin e qeverisjes dhe komunikimit të brendshëm, planifikimit strategjik dhe



operativ, metodologjisë së auditimit të rregullsisë dhe performancës, si dhe në ndërtimin e një sistemi të strukturuar të menaxhimit të cilësisë. Gjithashtu, raporti vlerëson përmirësimin e vazhdueshëm të raportimit dhe të mekanizmave për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Raporti ka identifikuar edhe fusha

për përmirësim të mëtejshëm, përfshirë forcimin e garancive ligjore për pavarësinë institucionale, veçanërisht në aspektin e autonomisë financiare, integritimin e plotë të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve, zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, zhvillimin e mëtejshëm të metodologjisë së auditimit si dhe

përfundimin e zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca e cilësoi raportin vijues si konfirmim të përparimit të arritur nga ZKA-ja në zbatimin e rekomandimeve të vitit 2023, por edhe si një udhërrëfyes i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. “Vlerësimi i pavarur i realizuar nga SIGMA është dëshmi e progresit që kemi arritur në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përafrimin e mëtejshëm të praktikave tona me standardet ndërkombëtare të auditimit. Rekomandimet e raportit do të shërbejnë si bazë për vazhdimin e reformave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të punës sonë, me qëllim rritjen e

cilësisë së auditimit dhe forcimin e llogaridhënies në sektorin publik”, theksoi auditorja e përgjithshme.

Raporti vijues është realizuar me kërkesë të auditores së përgjithshme për ta vlerësuar përparimin në zbatimin e rekomandimeve të rishikimit kolegjial të vitit 2023 dhe për të ofruar orientime për zhvillimin e mëtejshëm strategjik të institucionit.

Rishikimi vijues ka shqyrtuar përparimin e ZKA-së në pesë fusha kryesore: pavarësinë dhe kornizën ligjore, qeverisjen dhe menaxhimin, metodologjinë dhe praktikën e auditimit, menaxhimin e cilësisë si dhe raportimin dhe arritjen e rezultateve.

IKShPK dhe KRU “Prishtina” bashkëpunojnë për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm

PRISHTINË, 21 GUSHT - Përfaqësues të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Qendrës Rajonale të Shëndetësisë Publike-Prishtinë (QRShP) dhe të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Prishtina” (KRU) zhvilluan një takim të përbashkët lidhur me monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe forcimin e

bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve. Gjatë takimit u diskutua gjendja aktuale e cilësisë së ujit të pijshëm, aktivitetet e monitorimit, aktivitetet e realizuara, projektet dhe raportet e përgatitura si dhe ato që janë në proces të përfundimit. Kryeshefi ekzekutiv i KRU “Prishtina”, Arsime Fetahu, theksoi angazhimin e kompanisë për

sigurimin e furnizimit të vazhdueshëm me ujë për qytetarët e rajonit të Prishtinës, me synim furnizimin 24 orë në ditë si dhe garantimin e ujit të sigurt dhe cilësor për konsum. Drejtoresha ekzekutive e IKShPK-së, dr. Ardita Baraku, shprehu gatishmërinë për vazhdimin e monitorimit të rregullt të cilësisë së ujit të pijshëm, përcjelljen dhe

vlerësimin e rezultateve të analizave si dhe bashkëpunimin e ngushtë me KRU “Prishtina”, me qëllim të reagimit në kohë ndaj çdo situatë që mund të ndikojë në sigurinë e ujit të pijshëm.

IKShPK dhe KRU “Prishtina” do të vazhdojnë ta forcojnë bashkëpunimin përmes shkëmbimit të rregullt të informacionit dhe koordinimit të



aktiviteteve me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe sigurimit të ujit të sigurt dhe cilësor për qytetarët.

SHPIKJET E MËDHA QË ERDHËN NGA BOTA ISLAMIKE

Ndërsa përhapja e Islamit dhe lulëzimi që njohu bota islamike përfshiu qendrat e mëdha kulturore të Antikitetit, përpjekja për të rizbuluar trashëgiminë klasike greke hapi një epokë zbulimesh shkencore dhe risish teknologjike.

Një mijë vjet më parë, në qytetin e Bagdadit, ata që dinin të lexonin arabisht kishin pothuajse të njëjtën mundësi për t'u njohur me veprat e Aristotelit dhe të shumë autorëve të tjerë të shkencës klasike, siç kanë lexuesit sot.

Kjo u bë e mundur falë Kalifatit Abasid, i cili, në kulmin e fuqisë së tij në shekullin VIII, ndërmori një nismë ambicioze përktimesh. U dha dijetarëve arabë qasje në veprat e mëdha filozofike dhe shkencore të persëve, indianëve, babilonasve, egjiptianëve dhe, mbi të gjitha, të grekëve.

Pushtimet islame kishin sjellë nën sundimin arab qendrat e lashta kulturore të botës helenistike, nga Siria dhe Egjipti deri në Iran. Ky zgjerim ushqeu atë që njihet si "Epoka e Artë Islame", e cila do të zgjaste deri në pushtimin mongol të shekullit XIII.

Falë përpjekjeve të kalifëve, qytete si Bagdadi u shndërruan në qendra të dijes, ku lulëzuan studimet e matematikës, astronomisë, optikës dhe mjekësisë. Bota arabe jo vetëm e ruajti dhe e përhapi këtë trashëgimi intelektuale, por e pasuroi atë me kontribute të reja, duke hedhur kështu themelet e përparimeve të mëvonshme shkencore që do të ndikonin në të ardhmen e Perëndimit.

MATEMATIKA E RE NGA BOTA ISLAMIKE

Ndër drejtuesit e Shtëpisë së Urtësisë së Bagdadit, ose Bayt al-Hikmah, ishte matematikani dhe astronomi al-Khwarizmi, i cili luajti një rol vendimtar në përhapjen e sistemit dhjetor të numërimit.

Libri i tij Mbi Artin Hindu të Llogaritjes, i cili ka mbijetuar vetëm nëpërmjet përkthimit të tij latin, Algoritmi de numero indorum, e njohu Perëndimin me shifrat nga një deri në nëntë, si dhe me konceptin e zeros.

Bashkë me to erdhën edhe koncepti i vlerës pozicionale, sipas të cilit vlera e çdo shifre në një numër përcaktohet nga pozicioni i saj. Për shembull, në numrin 123, njëshi përfaqëson qindëshet, dyshi dhjetëshet dhe treshi njëshet.

Puna e al-Khwarizmit ishte thelbësore për kalimin nga sistemi romak i numërimit, shumë më kompleks dhe i kufizuar për kryerjen e llogaritjeve, te sistemi hindu-arab i numërimit që përdorim sot. Duke i bërë llogaritjet më të thjeshta, reformat e al-Khwarizmit përfaqësuan një revolucion në botën e matematikës, megjithëse ato nuk u përhapën gjerësisht deri disa shekuj më vonë.

Libri i tij ishte gjithashtu shkak për



krijimin e pershtypjes së përhapur, por të pasaktë, se sistemi ynë i sotëm i numërimit është me origjinë arabe. Në fakt, ai bazohet në një përkthim arab të sistemit numerik të Brahmaguptës, matematikan dhe astronom hindu i shekullit VII, i cili ishte arkitekti i vërtetë i këtij sistemi.

Në shekullin XII, përkthimet latine përdorën shprehjen "the al-Khwarizmi" për sistemin e numërimit që ai kishte shpjeguar. Gjatë përkthimit, kjo u shtrembërua në "algorismi", prej së cilës më pas lindi fjala algoritëm.

Por sistemi i numërimit nuk ishte i vetmi koncept që al-Khwarizmi i solli matematikës perëndimore. Në një tjetër libër, ai hodhi themelet e matematikës arabe dhe u bë themeluesi i algebrës, një fjalë që rrjedh nga termi arab al-jabr, që do të thotë "plotësim" ose "rivendosje". Përdorimi i shkronjave për të përfaqësuar numra të panjohur, për shembull, $x^2 + 10x = 39$, mundësoi metoda shumë më të thjeshta për zgjidhjen e ekuacioneve të shkallës së dytë, ose ekuacioneve kuadratikë.

MJEKËSIA DHE KIRURGJIA

Bota arabe mesjetare përjetoi gjithashtu zhvillime të

rëndësishme shkencore në mjekësi.

Vepra të tilla si Kanuni i Mjekësisë i shkencëtarit dhe filozofit pers Ibn Sina, i njohur në Perëndim edhe si Avicena, qenë themelore për formimin e mjekëve në Evropë për shekuj me radhë.

Ndërkohë, mjekë të tjerë arabë, si andaluziani Abu al-Qasim al-Zahrawi, i njohur në Perëndimin e krishterë si Albucasis, dhanë kontribute të rëndësishme me karakter praktik.

Në enciklopedinë e tij mjekësore dhe kirurgjikale, "Metoda e Mjekësisë", al-Zahrawi përshkroi me hollësi të madhe sëmundje të ndryshme dhe trajtimet e tyre, si dhe procedurë kirurgjikale.

Al-Zahrawi paraqiti një sërë risish: trajtimin kirurgjikal të venave varikoze, lidhjen e enëve të gjakut në rastet e hemorragjive arteriale, heqjen e bajameve, përdorimin e kateterit për drenimin e urinës nga fshikëza, vendosjen e pacienteve në pozicionin litotomik për ekzaminime gjinekologjike, si dhe përdorimin e fashave të ngurtësuar me miell dhe të bardhë veze për stabilizimin e kockave të thyera.

Al-Zahrawi theksonte gjithashtu rëndësinë e njohurive anatomike. Në hyrjen e enciklopedisë së tij ai shkruan: "Pashë një mjek të paditur që preu një tumor skrofuloz në

qafën e një gruaje. Ai preu disa arterie në qafë, duke shkaktuar një hemorragji që vazhdoi derisa ajo vdiq në duart e tij."

Vepra ishte konceptuar si një mjet për studentët e mjekësisë, të cilëve u kërkohet t'i nënshtroheshin një periudhe trajnimit përpara se të mund të ushtronin profesionin.

Përveç shkrimit dhe mësimdhënies, al-Zahrawi ishte edhe novator në projektimin e instrumenteve kirurgjikale. Ai shpiku dhe përshkroi mjete të tilla si kauteri, një shufër metalike që nxehej deri në skuqje dhe përdorej për kauterizimin e indeve, sharrën për prerjen e kockave, pincat për heqjen e dhëmbëve dhe gërsërët për synet.

Këto instrumente, të projektuara për të kryer detyra me saktësi dhe efikasitet, revolucionarizuan praktikën kirurgjikale.

CAMERA OBSCURA

Ibn al-Haytham, i njohur edhe si Alhazen, ishte një dijetar arab i shekullit X dhe konsiderohet një nga etërit e optikës moderne. Vepra e tij Optics është një traktat gjithëpërfshirës mbi natyrën e dritës, shikimin dhe instrumentet optike, në të cilin ai përshkruan me saktësi dukuri të tilla si reflektimi, përtërja e dritës dhe formimi i imazheve në

sy. Përveçse ishte një teoricien i madh, al-Haytham ishte një eksperimentues i palodhur. Ai ndërtoi instrumente optike dhe projekttoi eksperimente për të vënë në provë hipotezat e tij, duke përdorur një qasje rigoroze të bazuar në prova.

Duke vëzhguar se si drita, kur kalonte përmes një hapjeje të vogël, projektonte imazhe të përmbytura mbi muret e një dhome të errët, al-Haytham zbuloi një parim themelor të optikës: formimin e imazheve nëpërmjet dritës.

Ky eksperiment i thjeshtë ndihmoi për të kuptuar më mirë funksionimin e syrit të njeriut dhe hodhi themelet për zhvillimin e instrumenteve optike, si kamerat dhe teleskopët.

Ai demonstroi gjithashtu se drita udhëton në vijë të drejtë dhe se shikimi ndodh kur drita që vjen nga objektet arrin në sy, duke rrëzuar teoritë e lashta sipas të cilave shikimi krijohet nga rreze që dilnin prej vetë syve.

KOZMOGRAFIA DHE HAR- TOGRAFIA

Astrolabët ishin ndër instrumentet më të famshme të botës arabe mesjetare. Megjithëse origjina e tyre daton që në shekullin VI, arabët bënë

përparime të mëdha në projektimin dhe përsosjen e tyre. Hartat qiellore përdorëshin për të llogaritur pozicionet e yjeve dhe të Diellit, megjithëse paraqitjet e qiellit mbështeteshin ende mbi modelin gjeocentrik të universit, ku Toka konsiderohej në qendër dhe të gjithë trupat e tjerë qiellorë rrotulloheshin rreth saj. Astrolabët u përdorën gjerësisht në botën islame sepse mundësonin përcaktimin e kiblës (qibla), drejtimit të Qabes në Mekë, dhe llogaritjen e orareve të lutjeve të përditshme, të cilat ndryshojnë në varësi të pozicionit të Diellit dhe Hënës. Pavarësisht përparimeve në astronomi dhe teorive të Kopernikut e Galileos, të cilat e zhvendosën Tokën nga qendra e

universit, astrolabët vazhduan të përdorëshin për shekuj për shkak të praktikës dhe saktësisë së tyre. Megjithëse busulla u shpik në Kinë, ishte në Al-Andalus, në shekullin XI, ku u krijua busulla e parë që përdorte një gur magnetik lundrues. Kjo pajisje, e cila shfrytëzonte magnetizmin natyror të Tokës për të orientuar gurin magnetik, u mundësonte marinarëve të ruanin një drejtim të qëndrueshëm në det të hapur, duke lehtësuar kështu lundrimin detar. Arabët bënë edhe përparime të tjera të rëndësishme në navigacion. Ata përdorën velën trekëndore, e cila u mundësonte të shfrytëzonin erërat anësore dhe të lundronin në drejtime që

më parë ishin të vështira për t’u arritur. Gjithashtu, rremat anësorë të anijeve u zëvendësuan me timonin në pjesën e pasme të anijes, duke u dhënë mjeteve lundruese kontroll dhe manovrueshmëri më të madhe.

VËLLEZËRIT BANU MUSA

Në shekullin IX, në Shtëpinë e Urtësisë në Bagdad, tre vëllezërit Banu Musa u bënë mjeshtër të mekanikës. Shumë nga shpikjet e përshkruara në Librin e Pajisjeve të Zgjuara, dukeshin sikur kishin dalë drejtpërdrejt nga një përrallë. Libri revolucionarizoi konceptin e inxhinierisë mekanike dhe parashikoi një sërë zhvillimesh

teknologjike që do të shfaqeshin shekuj më vonë. Ndër shpikjet e Banu Musa-s kishte automate të afta për të kryer detyra, si servirja e pijeve ose luajtja e instrumenteve muzikore. Libri përshkruan gjithashtu një gamë të gjerë pajisjesh hidraulike, si pompa dhe sifone, të cilat mund të përdorëshin për të lëvizur ujin dhe për të kryer detyra të tjera me rëndësi themelore për zhvillimin e bujqësisë dhe industrisë në botën arabe. Këto shpikje nuk ishin vetëm dëshmi e aftësive teknike të vëllezërve, por tregonin gjithashtu se si inxhinieria e kohës përpiqej të imitonte dhe të përmirësonte funksionet njerëzore.

PERËNDIMI I NJË EPOKE TË ARTË

Megjithëse disa studiues argumentojnë se Epoka e Artë Islame kishte nisur tashmë të hynte në rënien e vet, përgjithësisht pranohet se goditja që shënoi fundin e saj përfundimtar erdhi nga ushtritë mongole. Në fillim të vitit 1258, Bagdadi u rrethua dhe u plaçkit. Shtëpia e Urtësisë dhe bibliotekat e paçmueshme të qytetit u shkatërruan. U hodhën aq shumë libra në lumin Tigër, saqë, sipas rrëfimeve, ujërat e lumit u nxinë nga boja e tyre. / NG History – Bota.al

ISLAMI MESJETAR, TOKA E RISIVE

PËRHAPJA E PANDALSHME E ISLAMIT drejt Lindjes i çoi ushtritë myslimane në territoret e kontrolluara nga dinastia Tang. Në vitin 751, ato mposhtën forcat kineze në Betejën e Talasit, në territorin e Kirgistanit të sotëm. Kalifati Abasid shtrihej në një sipërfaqe prej më shumë se katër milionë miljesh katrore, nga Azia Qendrore deri në Gadishullin Iberik. Arabët përvetësuan risitë me të cilat u ndeshën në këtë hapësirë të jashtëzakonshme, duke u shndërruar në forcën shtytëse të një revolucioni teknologjik dhe kulturor, i cili, me kalimin e kohës, do të arrinte edhe në Evropë.



SHTËPIA E URTËSISË

I krijuar në vitin 762 si kryeqyteti i dinastisë së re Abaside, e cila në vitin 750 kishte rrëzuar Umajadët e Damaskut, Bagdadi u bë vendi ku ndodhej Bayt al-Hikmah, ose Shtëpia e Urtësisë, e themeluar nga kalifi al-Ma'mun (i cili sundoi nga viti 813 deri më 833). Kjo akademi dhe bibliotekë nxiti përkthimin e trashëgimisë shkencore dhe filozofike të Antikitetit, nga bota greke, perse dhe siriake. Përkthimet përfshinin fusha si mjekësia, me vepra të Galenit, Hipokratit dhe Pedanius Dioscoridesit, e drejta,

astronomia dhe shkenca të tjera, përfshirë veprat e Ptolemeut, Euklidit dhe Arkimedit. Dijetarë iranianë, arabë, nestorianë, hindu dhe sabeanë trajtonin çështje shkencore, fetare dhe filologjike, i kushtoheshin vëzhgimit të natyrës dhe kërkonin arritje konkrete, si shpikja e instrumenteve për vëzhgim dhe eksperimentim, si edhe hartimi i tabelave astronomike. Pikërisht në këtë mjedis morën formë algjebra dhe një shkencë e re e optikës. Nga shekulli VIII e në vazhdim, prodhimi i letres e bëri më të lehtë përhapjen e dijes dhe çoi në zhvillimin e bibliotekave. Shkenca dhe filozofia që Islami

edhe nestorianët, të cilët perandori bizantin Justiniani I, mbrojtës i ortodoksisë së krishterë, i kishte shpallur heretikë dhe i kishte dëbuar nga territoret e tij. Më vonë, në vitin 529, Justiniani ndaloi mësimin e filozofisë greke dhe mbylli Akademinë e Athinës, të themeluar nga Platoni. Ndërkohë, dijetarët nestorianë dhe grekë të dëbuar u mirëpritën nga mbreti pers Khosrovi I në akademinë e tij të shkëlqyer në Gondeshapur, ku siriakishtja ishte gjuha e shkencës. Kur arabët pushtuan Persinë në vitin 637, kjo qendër e rëndësishme intelektuale ra në duart e tyre. Shtëpia e Urtësisë në Bagdad u modelua sipas akademisë së Gondeshapurit, në territorin e Iranit të sotëm. Atje, me ndihmën e dijetarëve nestorianë, një numër i madh veprash shkencore dhe filozofike u përkthyen në arabisht.

SHIFRAT ARABE: NGA INDIA NË GJITHË BOTËN

Ishte al-Khwarizmi ai që, në shekullin IX, përhapi sistemin indian të numërimit me bazë dhjetore, përfshirë edhe shënimin pozicional të zeros, me prejardhje nga sanskritishtja. Fjala arabe për “zero” është sifr, që do të thotë “bosh”. Prej saj lindi fjala “cipher” dhe, në disa gjuhë evropiane, edhe fjala që përdoret për “shifër”, si për shembull frëngjishtja chiffre. Codex Vigilanus Codex Vigilanus, i hartuar nga murgj në vitin 976, përmban këtë paraqitje të shifrave arabe, pa zeron, dhe është dëshmia e parë e njohur e përdorimit të tyre në Perëndim.

ALEMBIKU

Me origjinë greke dhe i përdorur në Perandorinë Bizantine, alembiku u përsos nga arabët. Kjo pajisje ishte thelbësore për distilimin e lëngjeve, parfumeve dhe ilaçeve, përmes një procesi avullimi dhe kondensimi të mëpasshëm.

KUPA E KHOSROVIT



Kupa e Khosrovit, e quajtur më parë Kupa e Solomonit, paraqet në qendër një mbret sasanid të shekullit VI. *Biblioteka Kombëtare, Paris.*

MULLIRI I ERËS

Përmendja e parë e mullinjve të erës daton në vitin 644, në Persi. Mullinjtë persianë kishin një bosht vertikal dhe, me pushtimet arabe, ky projekt u përhap gjerësisht në të gjithë Lindjen e Mesme. Përmendja më e hershme e mullinjve të erës në botën islame gjendet në Librin e Pajisjeve të Zgjuara, shkruar në shekullin IX nga tre vëllezërit Banu Musa. Këta mullinj me bosht vertikal në Nashtifan, Iran, të konsideruar si mullinjtë e erës më të vjetër në botë, janë ende në funksionim edhe sot.

SHAHU

Origjina e tij gjendet në një lojë indiane të quajtur chaturanga, e cila mbërriti në Persi me emrin shatranj. Pushtimi arab i Persisë e përhapi dhe e popullarizoi lojën në të gjithë botën ilame. Më pas, shahu arriti në botën e krishterë perëndimore përmes Al-Andalusit, territorit mysliman në Gadishullin Iberik, në Spanjën e sotme.


INSTITUCIONET E PARA PSIKIATRIKE

PRAKTIKAT MJEKËSORE NOVATORE ishin të shumta në

botën islame mesjetare. Ndër to ishte edhe zhvillimi i spitalit si institucion, i njohur si bimaristan, nga fjala perse bimar, që do të thotë “i sëmurë”, dhe i frymëzuar nga spitali i madh i krijuar nga mbretërit sasanidë në Gondeshapur. Bimaristani i parë u themelua në vitin 710 në Damask, nga kalifi umajad al-Walid I, dhe duke nisur nga shekulli IX, institucione të tilla u shumëfishuan. Një risi e veçantë ishte krijimi i spitaleve për trajtimin e njerëzve që konsideroheshin të sëmurë mendërisht. Filologu al-Mubarrad kishte përshkruar një vizitë në një spital ku pacientët mbaheshin të lidhur me pranga. Episodet akute trajtoheshin me forcë dhe kamxhikë. Megjithatë, dëshmitë tregojnë se në disa raste pacientët trajtoheshin në mënyrë më humane: një rrëfim i shekullit XIII përshkruan pacientë që shfaqnin mani dhe që trajtoheshin me opium të holluar në ujë elbi. Për sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit, dihet se në Bagdad, magjistratët i vizitonin pacientët çdo muaj dhe urdhëronin lirimin e atyre që konsideroheshin të shëruar. Më pas, ata ktheheshin në shtëpitë e tyre, ku vazhdonin të merrnin kujdes mjekësor.

INSTRUMENTET KIRURGJIKALE

AL-ZAHRAWI (I NJOHUR EDHE SI ALBUCASIS) lindi rreth vitit 936 në qytetin mbretëror të Medina Azahara-s, pranë Kordobës. Sipas gojëdhënave, ai shërbeu si mjek i kalifit Abd al-Rahman III. Traktati i fundit i përmbledhjes së tij prej 30 vëllimesh, Metoda e Mjekësisë, i kushtohet kirurgjisë dhe përmban vizatime të më shumë se 200 instrumenteve kirurgjikale, të lidhura me procedurat që ai përshkruan. Ato përfshijnë si kirurgjinë e përgjithshme, nga trajtimi i tumoreve deri të përdorimi i kupave thithëse, ashtu edhe fushat në të cilat ai ishte i specializuar: oftalmologjinë, stomatologjinë, urologjinë, obstetrikën dhe gjinekologjinë. / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli përforcohet me portierin Kolaj

DRENAS, 21 GUSHT - Feronikeli ka vazhduar përforcimet për sezonin e ri, duke zyrtarizuar transferimin e portierit Agron Kolaj. Klubi nga Drenasi ka bërë me dije se ka

arritur marrëveshje me Kolajn, i cili në të kaluarën ka mbrojtur edhe te Besa e Pejës, Llapi, FC Prishtina dhe SC Gjilani. Portieri Kolaj ka qenë pjesë e

edhe e Përfaqësueses së Kosovës U21. "Mirë se erdhe në familjen tonë, Agron! Të urojmë shumë suksese me fanellën e FC Feronikeli 74", ka njoftuar

klubi nga Drenasi. Me ardhjen e Kolajt, Feronikeli synon ta rrisë konkurrencën në portë dhe ta kompletojë skuadrën para fillimit të sezonit të ri.



DRITA BARAZON NË 'FADIL VOKRRI' NDAJ INTER D'ESCALDES

PRISHTINË, 21 GUSHT - FC Drita ka barazuar 2:2 me Inter D'Escaldes në ndeshjen e parë të fazës së "play-off"-it për kualifikim në fazën e ligës të UEFA Conference League, e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kampionia e Kosovës ka kaluar dy herë në epërsi, por skuadra nga Andorra ka arritur të kundërpërgjigjej në të dyja rastet, duke bërë që gjithçka të mbetet e hapur për ndeshjen e

kthimit. Drita e ka nisur ndeshjen në mënyrën më të mirë, duke realizuar që në minutën e 4-t. Hajdin Salihu shënoi me kokë pas një harkimi të William Baeten për t'i dhënë epërsinë 1:0 skuadrës gjilnase. Megjithatë, mysafirët kanë reaguuar shpejt dhe në minutën e 13 Domi Berlanga barazoi rezultatin në 1:1. Para përfundimit të pjesës së parë, Drita ka rikthyer epërsinë. Në

minutën e 42-të Blerim Krasniqi ka shënuar për 2:1 pas asistimit të Igball Jasharit. Megjithatë, në pjesën e dytë Inter D'Escaldes ka arritur sërish të barazojë. David Lopez ka përfutur nga një situatë në zonën e Dritës dhe në minutën e 56 ka shënuar për rezultatin përfundimtar 2:2. Kësisoj, skuadra që do të kalojë në fazën e ligës të UEFA Conference League do të përcaktohet javën e ardhshme.



VJEN FITORJA E PARË NË LOJËRAT MESDHETARE, VOLEJBOLLISTET E KOSOVËS MPOSHTIN ALGJERINË



TARANTO, 21 GUSHT - Kombëtarja e Kosovës në volejboll ka shënuar fitoren e parë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026". Volejbollistet "dardane" kanë triumfuar bindshëm 3:0 në sete ndaj Algjerisë në ndeshjen e

zhvilluar të premtën. Kosova e ka dominuar takimin që nga fillimi, duke shfrytëzuar edhe nivelin më të dobët të kundërshtarit. Seti i parë ka përfunduar 25:19, ndërsa në të dytin Algjeria ka arritur të marrë

vetëm 10 pikë. Në setin e tretë algjerianet kanë grumbulluar 14 pikë. Kjo ishte fitorja e parë e Kosovës në "Taranto 2026", pasi një ditë më parë volejbollistet "dardane" ishin mposhtur 3:0 nga Greqia. Në grupin e Kosovës

bëjnë pjesë edhe Maqedonia e Veriut dhe Turqia, ndërsa në grupin tjetër janë Italia, Bosnjë-Hercegovina, Egjipti dhe Serbia. Kosova po merr pjesë në Lojërat Mesdhetare "Taranto 2026" me gjithsej 163 sportistë.

KLUBET E PREMIERLIGËS SHPENZUAN MË SHUMË SE KOMPLET KATËR LIGAT E TJERA MË TË FORTA EVROPIANE

LONDËR, 21 GUSHT - Premierliga është edhe një herë mbretëresha dhe padronja e tregut veror të futbollit, ndërsa diferenca tashmë është zyrtarisht e dukshme dhe e paarritshme. Klubet angleze e kanë kaluar shifrën rekord të 2 miliardë funteve të investuara, duke tejkaluar, deri tani, të vetme shpenzimet totale të ligave më të forta si Serie A, La Liga, Bundesliga dhe Ligue 1 të marra së bashku. Në krye të këtij demonstrimi epokal të fuqisë financiare janë dy transferime të ngjashme, që e kanë rishikuar historinë e futbollistëve britanikë më të shtrenjtë të të

gjitha kohëve. Sepse e pabesueshmja është se dy lojtarët më të shtrenjtë janë anglezë. Dhe, parë nga këndvështrimi ynë, është edhe më e pabesueshme që ata nuk janë dy futbollistë të konsideruar ndër më të mirët në botë. Uluni rehat. Dhe hapini mirë sytë, shkruan "Tuttomercatoweb". Chelsea, mbreti i padiskutueshëm i shpenzimeve të verës me më shumë se 400 milionë euro të investuara, e ka siguruar fronin duke e blerë Morgan Rogers nga Aston Villa për shifrën rekorde prej 137.3 milionë eurosh, për të qenë të



saktë. Përgjigjja e Manchester Cityt nuk ka vonuar. Klubi nga Manchesteri ka reaguuar duke e marrë Elliot Anderson nga

Nottingham Forest për plot 135 milionë euro. Dhe më pas është revolucioni i Tottenhamit, pas rënies thujtase katastrofike të sezonit të kaluar. 260 milionë euro të shpenzuara për t'i transferuar Sandro Tonalin nga Newcastle për 108 milionë euro, Mateus Fernandes nga West Ham për 99 milionë dhe Jan Paul van Hecke nga Brighton për 60 milionë. Pas mbijetesës së arritur në momentet e fundit, shpresa e Spurs është të rikthehen në garën për një vend në Champions League. Liverpools ka shpenzuar plot 63.6 milionë

euro për Jeremy Jacquet nga Rennes, ndërsa Aston Villa ka paguar 60 milionë për Johan Manzambi. Chelsea i janë dashur 61 milionë euro për Maxence Lacroix, ndërsa Brighton i ka shpenzuar 54 milionë euro për Luka Vusković. Shifra jashtëzakonisht të larta për futbollistë që sigurisht nuk janë emra të kopertinave. Nuk po flasim për të rinj apo talente që luftojnë për Topin e Artë. Janë transferime që e bëjnë edhe më të qartë diferencën mes kampionateve të tjera dhe Premierligës.

Trepça nis mbrojtjen e titullit ndaj Rahovecit, shorti përcakton javën e parë të Superligës në basketboll

PRISHTINË, 21 GUSHT - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në prani të përfaqësuesve të klubeve, është hedhur shorti për edicionin e ri të ProCredit Superligës. Kampionia e Kosovës, Trepça, do ta nisë mbrojtjen e titullit si

mysafire e Rahovecit 029 në xhiron e parë. Derbi i javës së parë do të zhvillohet ndërmjet rivalëve të vjetër, Sigal Prishtinës dhe Pejës, në një përballje që pritet të sjellë emocione të shumta që në start të kampionatit.

Trepça dhe Peja do të përballen në javën e dytë, ndërsa në xhiron e tretë do të takohen nënkampioni Bashkimi dhe kampionia Trepça. Edicioni i ri i ProCredit Superligës pritet të jetë mjaft interesant, me skuadrat që

synojnë ta japin maksimumin për t'i arritur objektivat e tyre. Java e parë do të zhvillohet më 19 dhe 20 shtator. Orari i shtatë xhirove të para është përcaktuar përmes shortit të zhvilluar në ambientet e FBK-së.



F2.3 / BNJ-KP / PT



0610316388
21.08.2026

REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" AD

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnim odnosima u RPO "Pastrimi" Sh. A., posebno član 11, stav 1.2 i član 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" AD, na osnovu Odluke Upravnog odbora br. Protokol 01/14/37 od 02/09/2025, na osnovu Odluke EK br. Protokol 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke EK o neispitnim pozicijama br. Protokol 7096 od 15.11.2024. godine, na osnovu Rešenja od 19.08.2026. godine sa brojem protokola 02/01/502 Direktora RPO-a "Pastrimi" d.o.o., izjavite ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla:

Traženi broj:

Referentni broj:

Koeficijent / Mesečna plata:

Trajanje ugovora o radu:

Probni period:

Radno iskustvo:

Vozač kategorije C i C1

Jedna (1) pozicija, OJ Drenas u RPO "PASTRIMI" AD

KP / PT / NJOD / 21-2026

Nivo XI

Stalno

3 meseca

1 godina radnog iskustva

1. Dužnosti i odgovornosti:

1.1 Vozi vozilo u skladu sa radnim nalogom u regionu koji je odredio supervizor;

1.2 je odgovoran za putovanje duž puteva i određenih područja za prikupljanje otpada u svojim prostorijama uređenim u skladu sa planiranjem kompanije;

1.3 pregledati životnu sredinu kako bi se identifikovao otpad koji treba prikupiti i kako bi se osiguralo da se radovi obavljaju u skladu sa zdravstvenim i bezbednosnim pravilima bez ometanja saobraćaja;

1.4 U saradnji sa liderom, planira najefikasnije rute za prikupljanje otpada iz dodeljenog područja kako bi se smanjio gubitak vremena i uštedjeli putni troškovi;

1.5 Odgovoran je za obezbeđivanje da je vozilo bezbedno i spremno za upotrebu, uključujući proveru nivoa goriva, proveru pritiska u gumama i ukupno održavanje vozila.

1.6 Vozač mora osigurati da se otpad klasifikovan kao eksploziv stavlja i transportuje sa posebnom pažnjom, poštujući propise o opasnom otpadu;

1.7 Izveštava o svim vanrednim situacijama koje se dešavaju tokom dužnosti, uključujući vanredne situacije, oštećenje vozila ili kršenje bezbednosti;

1.8 Brine i poštuje saobraćajna pravila;

1.9 Održava registar odgovornosti, u skladu sa propisima i politikama kompanije.

1.10 obavlja i druge poslove na zahtev direktnog supervizora;

1.11 Za svoj rad odgovara rukovodiocu Operativne jedinice.

2. Opšti kriterijumi za zapošljavanje:

✓ Mora biti državljanin Republike Kosovo,

✓ mora vladati najmanje jednim od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;

✓ Mora biti sposoban za obavljanje odgovarajuće dužnosti;

✓ Da nije osuđen za počinjenje krivičnog dela;

✓ Ne smije postojati disciplinska mjera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;

✓ Mora imati vještine potrebne za poziciju

✓ Da uspešno prođe procedure prijema definisane zakonom.

3. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

✓ Biti oprezan i obratiti pažnju na detalje;

✓ Sposobnost samostalnog rada;

✓ Veštine korisničkog servisa;

✓ Poznavanje javne bezbednosti;

✓ Sposobnost da dobro rade sa rukama;

✓ Fizička spremnost i izdržljivost;

✓ Sposobnost organizovanja vremena i radnog opterećenja;

✓ Dobre veštine verbalne komunikacije.

4. Dokumenti koji se dostavljaju u okviru prijave i način njihovog podnošenja

Prijava za zapošljavanje i biografija, popunjen i potpisan od strane kandidata	✓
Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova (poželjno)	✓
Kopija dokaza o zapošljavanju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (opcionarno)	✓
Kopije ouena rada za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Identifikacioni dokument Republike Kosovo	✓
Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci	✓

4.1 Posebni dokumenti

- Obavezna vozačka dozvola za vozače kategorija B, C i C1

4.2 Oblik javnog konkursa bez testiranja (KP/PT):

-Konkurs za ovo radno mesto se sprovodi po posebnom postupku, bez pismenog testa, i obuhvata samo ocjenu CV-a i stručni intervju.

5. Postupak prijave na konkurs i podnošenje prijave:

5.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:

* preuzimanjem sa zvanične Facebook stranice: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" AD na recepciji kompanije.

5.2 Podnošenje prijave:

* Zahtevi za zapošljavanje, sa kompletnom dokumentacijom, podnose se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i

* U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i fizički preko arhive kompanije.

6. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 22/08/2026. do 07/09/2026. godine.

Rok za podnošenje prijava je 16:00 časova.

Sve prijave podnesene nakon isteka roka neće se razmatrati.

7. Metod evaluacije i kriterijumi bodovanja.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prolaz ostvarivanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza javnog konkursa.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:

✓ CV kandidata: do 25 bodova

✓ Intervju: do 75 bodova.

8. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

9. Približan raspored postupka zapošljavanja:

Preliminarna verifikacijska faza prijava do 7 dana;

Faza pismenog testiranja traje do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjuja traje do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Rezultati se objavljuju do 3 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena:

Nepotpuna ili neskenirana dokumenta, kao i ona koja stignu nakon isteka roka za takmičenje, neće se razmatrati.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

